

Ne festojmë përvjetorin e 30-të të programit Erasmus – një arritje për Evropën. Me këtë rast, Zyra Erasmus+ në Shqipëri, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Rrjeti i Informimit i BE-së organizojnë:

ERASMUS + Konkursi i eseve dhe arteve të bukura

“Evropa ime”

Përdorni artin për të përshkruar se si ka ndikuar në jetën tuaj përvoja Erasmus!
Ndani me ne historinë tuaj frymëzuese!

Kategoritë

Çmimet

<i>Ese*</i>	-Eseja më e mirë	- € 100
<i>Fotografi**</i>	-Fotografia më e mirë	- € 100
<i>Vizatim</i>	-Artet e tjera	- € 100
<i>Pikturë</i>	<i>(Vizatim, Pikturë, Video, Skulpturë, Qeramikë)</i>	
<i>Video</i>	- Dhjetë esetë dhe veprat më të mira do të paraqiten në albumin e konkursit dhe do të ndahen në faqen tonë web, si dhe në faqen në Facebook.	
<i>Skulpturë</i>		
<i>Qeramikë</i>		

Kërkesat për pjesëmarrje:

Gjithë qytetarët shqiptarë që kanë qenë pjesë e programit Erasmus+ apo pararendësve të tij (Tempus, Erasmus Mundus, Jean Monnet, YOUTH) kanë të drejtë të marrin pjesë.

Lejohet vetëm një ese dhe deri në tri vepra arti për pjesëmarrës.

Puna e paraqitur duhet të jetë origjinale dhe jo një riprodhim apo derivat i një veprë arti tjetër. Vetëm veprat e krijuara pas 15 majit 2017 do të pranohen në konkurs.

* Gjuhët e eseve: shqip ose anglisht. Eseja nuk duhet t'i kalojë 1000 fjalët. Gjithë citimet apo faktet e pazakonta duhen cituar siç duhet.

**Fotografitë duhen shoqëruar me një përshkrim të shkurtër prej 150 fjalësh apo më pak që nënvizon ndikimin që ka pasur Erasmus tek ju.

Bazuar në kategoritë mund ta paraqisni krijimin tuaj në adresën e Zyrës Shqiptare Erasmus+: Sheshi Skënderbe, Pallati i Kulturës, Kt. 3; ose me email në: albania@erasmusplus.al me subjekt “Evropa ime”, jo më vonë se **25 tetori 2017**.

